



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 193, datë 04.06.2020

**PËR
HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM PËR NJË
POZICION TË LIRË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË
SHKODËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” me ndryshime, duke konstatuar edhe cenimin e rëndë të funksionalitetit të gjykatës, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për transferim të përkohshëm deri në një vit.
2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar, aktualisht në Administrative të Shkallës së Parë Shkodër z. {...}, i cili të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.
3. Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.
4. Ngarkohet Komisioni për Zhvillimin e Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR